



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHËM NË KUADËR TË AKREDITIMIT
TË PJESSHËM INSTITUCIONAL**

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

Grupi *ad hoc* i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof Asoc. PhD. Kita Sallabanda Diaz
2. Prof. Ana Mane Kapaj

Raport i Grupit *ad hoc* të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ)
për verifikimin e standardeve për akreditimin e pjesshëm institucional të
Universitetit “Mesdhetar të Shqipërisë” (UMSH)

Draf raporti i vlerësimit të jashtëm në kuadër të akreditimit të pjesshëm institucional, u dërgua në institucion me anë të sistemit AMS në datë 14 Dhjetor. IAL përmes sistemit AMS më datë 18 Dhjetor, ka dërguar komentë mbi Draft raportin. Grupi *ad hoc* i vlerësimit të jashtëm pasi u njoh me komentet e institucionit vendosi:

Grupi *ad hoc* i vlerësimit të jashtëm vlerëson komentet e institucionit pasi lexoi Draft Raportin për Akreditimin e Pjesshëm Institucional dhe vendosi të mos ndryshojë Raportin e dërguar.

Konstatimet e bëra nga Grupi *ad hoc*, kanë për qëllim kryesor të nxisin institucionin drejt përmirësimeve të vazhdueshme, sidomos në drejtimitet e përmendura në raport. E vlerësojmë përditësimin nga ana e institucionit për rritjen e kapaciteteve akademike gjatë kësaj kohe, por raporti duhet ti referohet periudhës në të cilën është realizuar vizita.

I. Plani i takimeve të GVJ

GVJ i përbërë nga Prof. Kita Sallabanda dhe Prof. Dr. Ana Kapaj, i ngritur nga Bordi i Akreditimit, kreu vizitën pranë Universitetit “Mesdhetar të Shqipërisë” më datë 10 Tetor 2023 dhe i realizoi të gjitha takimet e parashikuara sipas planit të miratuar nga ASCAL dhe UMSH. Takimet e realizuara gjatë këtij takimi më konkretisht ishin:

- Takim me Rektorin e institucionit
- Takim me: Dekanin e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane dhe Dekanin e Fakultetit të Informatikës.
- Takim me: Drejtuesit e Departamenteve të Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane dhe Fakultetit të Informatikës.
- Takim me: Studentët e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane dhe Fakultetit të Informatikës.
- Takim me personelin akademik të Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane dhe Fakultetit të Informatikës.
- Takim me përfaqësues të zyrave mbështetëse të institucionit.

Gjithashtu u realizua dhe vizitë në ambientet e institucionit

II. Dokumentet në dispozicion të grupit “ad-hoc”


Dokumentet që u vunë në dispozicion të GVJ janë:

- Raport i vetevlerësimit për akreditimin e pjesshëm insitucional.pdf
- Plan Veprimi për përbushjen e rekomandimeve.pdf


Evidenca 1. Statuti UMSH.pdf

Evidenca 2. Rregullore e Organizimit UMSH.pdf


Evidenca 3. Organigrama.pdf



Evidenca 4. Plani Strategjik i Zhvillimit UMSH.pdf
Evidenca 5. Marreveshjet e bashkepunimit.pdf
Evidenca 5.1 Marreveshja me Swiss UMEF.pdf
Evidenca 5.2 Marreveshja _ Universiteti i Tuscias.pdf
Evidenca 5.3 Projekti Laia.pdf
Evidenca 6. Strategjia e Nderkombetarizimit.pdf
Evidenca 7. Rregullore VSA.pdf
Evidenca 8. Rregullore VBA.pdf
Evidenca 9. Rregullore Keshilli i Etikes.pdf
Evidenca 10. Kodi i Etikes.pdf
Evidenca 11. Kontrate Qiraje G2.pdf
Evidenca 12. Vendim nr.1 date 27.01.2020 _SA.pdf
Evidenca 13. Rregullore NJSBCZHK.pdf
Evidenca 14. Lista e projekteve UMSH.pdf
Evidenca 15. Raporti Vjetor i Institucionit.pdf
Evidenca 16. Procesverbal mbledhje Fakulteti.pdf
Evidenca 17.1 Rregullore per organizimin dhe punen e FI.pdf
Evidenca 17.2 Rregullore per organizimin dhe punen e FDSHH.pdf
Evidenca 18.1 Rregullore per organizimin dhe punen e departamentit te se drejtes te FDSHH.pdf
Evidenca 18.2 Rregullore per organizimin dhe punen e departamentit te IB te FI.pdf
Evidenca 18.3. Rregullore per organizimin dhe punen e departamentit TI te FI.pdf
Evidenca 19. Vendim per miratimin e Bordit te tregut te punes.pdf
Evidenca 20. Analiza e tregut te punes.pdf
Evidenca 21. Lista e konferencave UMSH.pdf
Evidenca 22.1 Lista e Marreveshjeve Erasmus +.pdf
Evidenca 22.2 Chart Erasmus+.pdf
Evidenca 22.3 Praktike Shkembimi Studentor Erasmus +.pdf
Evidenca 22.4 Staff Training Week Erasmus+.pdf
Evidenca 23. Lista e Personelit Akademik te Ftuar dhe te Huaj.pdf
Evidenca 24. Procedura e rekrutimit te stafit.pdf
Evidenca 25.1 Kontrata e punes tip PAE.pdf
Evidenca 25.2. Kontrate e Punes tip PAK.pdf
Evidenca 26. Lista e Stafit 2022-2023.pdf
Evidenca 27. Rregullore per studentet me aftesi ndryshe.pdf
Evidenca 28.a Broshura e programeve Bachelor.pdf
Evidenca 28.b Broshura e programeve Master.pdf
Evidenca 29.1 Raporti i Vetevleresimit Individual.pdf
Evidenca 29.2 Aneksi A Vleresimi i Performances.pdf
Evidenca 30. Formulari i Vleresimit te pedagogut nga Autoriteti Drejtues.pdf
Evidenca 31. Formulari i Vleresimit te pedagogut dhe lendes nga studenti.pdf
Evidenca 32.1 Tabela e te dhenave financiare 2017-2022.pdf
Evidenca 32.2_32.3 Pasqyrat financiare_Raporti i Auditimit.pdf
Evidenca 33. Plani i Trajnimeve.pdf
Evidenca 34. Relacioni i verifikimit te Godines.pdf
35.A.1 Plani Mesimor.pdf
35.A.2 Rregullore e programit te studimit.pdf
35.A.3 Misioni dhe objektivat.pdf
35.A.4 Syllabuse.pdf
35.A.5 Propozimi per hapjen.pdf
35.A.6 VSA.pdf
35.A.7 VBA.pdf



35.A.8 Urdher per hapjen e programit.pdf
35.A.9 Curriculum Vitae e personelit akademik.pdf
35.A.10 Urdheri per akreditimin.pdf
35.A.11 Specim Diplome.pdf
35.A.12 Suplementi i Diplomes.pdf
35.B.1 Plani mesimore.pdf
35.B.2 Rregullore Programi.pdf
35.B.3 Vizioni, Qellimi, Objektivat.pdf
35.B.4 Syllabuset_opt.pdf
35.B.5 Propozimi per hapjen.pdf
35.B.6 VSA.pdf
35.B.7 VBA.pdf
35.B.8 Urdher per riorganizim.pdf
35.B.9 Curricule vitae.pdf
35.C1 Plani mesimor.pdf
35.C2 Rregullore programi MP SIB.pdf
35.C3 Misioni dhe objektivat.pdf
35.C4 Syllabuset.pdf
35.C5 Propozimi per hapjen.pdf
35.C6 VSA.pdf
35.C8 Urdher per hapjen.pdf
35.C9 Curriculum Vitae e personelit akademik.pdf
35.C10 Urdher per akreditimin.pdf
35.C11 Specimen Diplome.pdf
35.C12 Specimen i Supplement Diplome.pdf
35.D1 Plani Mesimor.pdf
35.D2 Rregullore e programit.pdf
35.D3 Misioni dhe objektivat.pdf
35.D4 Syllabuset.pdf
35.D5 Propozimi per hapjen.pdf
35.D6 VSA.pdf
35.D8 Urdher per hapjen.pdf
35.D9 Curriculum Vitae e personelit akademik.pdf
35.D10 Urdher per akreditimin.pdf
35.D11 Specimeni i Diplomes.pdf
35.D12 Suplementi i Diplomes.pdf
Evidenca 36. VSA nr 11 dt 26.10.2018.pdf
Evidenca 37. Kalendari Skalete_ Java Orientuese UMSH.pdf
Evidenca 38. Urdher i riorganizimit te programeve Bsc Msc _FI_ FDSHH.pdf
Evidenca 39. Formular i Aplikimikt te studentit per praktiken.pdf
Evidenca 40. Procesverbal Mbledhje _Per diskutimin dhe rishikimin e syllabuseve.pdf
Evidenca 41. Programi i Konferences shkencore studentore.pdf
Evidenca 42. Udhezues per pergatitjen e diplomes.pdf
Evidenca 43 Kerkese per libra Departamenti i Teknologjise se Informacionit.pdf
Evidenca 44 Udhezimi mbi procedurat dhe afatet e sezonit te provimeve dhe plani i punes per sezonin.pdf
Evidenca 45. Udhezim hartim teze.pdf
Evidenca 46. Procedurat e punes me fokus grupet.pdf
Evidenca 47 Permbledhese Tabela drejtimet kerkimore.pdf
Evidenca 48 Udhezim per dokumentacion per evidentimin dhe vleresimin e punes.pdf



Evidenca 49. Rregullore e ZKSK.pdf
Evidenca 50. Rregullore e funksionimit te keshillit Studentor.pdf
Evidenca 51. Formular Toturiati.pdf
Evidenca 52. Udhezuesi i Studentit.pdf
Evidenca 53. Formatet e praktikes.pdf
Evidenca 54. Plani i punes i NJSBCZHK.pdf
Evidenca 55. Kalendar i aktiviteteve akademike UMSH.pdf
Evidenca 56. Urdher per Higjenen dhe zjarrin.pdf
Evidenca 57. Agjenda e Takimit Alumni.pdf
Evidenca 58. Manual i perdorimit te platformave elektronike.pdf
Evidenca 59.1 Propozimi per hapjen CFPP.pdf
Evidenca 59.2 Rregullorja CFPP.pdf
Evidenca 59.3 Plani mesimor CFPP.pdf
Evidenca 60. Plani i punes shkencore per njesine baze dhe raport per aktivitetet e zhvilluara ne FDSHH.pdf
Evidenca 61. Material per biblioteken.pdf
Evidenca 62. Miratimi per hapjen e programit te doktoratures.pdf
Evidenca 63.1 Miratim i organizimit te programit te studimit ne gjuhe te huaj.pdf
Evidenca 63.2 Miratim i organizimit te programeve doktorale ne gjuhe te huaj.pdf
Evidenca 64. Urdher i Rektorit per shkembimet Erasmus+.pdf
Evidenca 65. Lista e klubeve studentore ne UMSH.pdf
Evidenca 66. Axhenda e Informacioneve shkencore te departamentit.pdf
Evidenca 67. Lista e studenteve qe kane perfituar nga programet Erasmus+.pdf
Evidenca 68. Procedura e Financimit te nje monografie Botimi konference.pdf
Evidenca 69. Kerkesa e dorezuar e doktoraturave me udheheqes shkencor te dyfishte.pdf
Evidenca 70. Marreveshja e Bashkepunimit Me shoqaten e prodhuesve shqiptar.pdf
Evidenca 71. Udhezim per dokumentacionin per evidentimin dhe vleresimin e punes shkencore.pdf
Evidenca 72. Evidenca te levizjes se stafit akademik dhe administrativ.pdf
Evidenca 73. VSA per ngritjen e Komisionit te Perhershem te Sigurimit te Cilesise.pdf
Evidenca 74: SELF EVALUATION REPORT - MUA.pdf

III. Gjendja e infrastrukturës së UMSH

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë e ushtron aktivitetin e tij në një godinë me kushtet të mira. Gjithashtu për vitin akademik 2023-2024, UMSH ka marrë me qera një godinë shumë afër godinës qendrore për të rritur kapacitetet pritëse të institucionit. Grupi *ad hoc* i Vlerësimit të Jashtëm shpreh mendimin se pavarësisht përpjekjeve të institucionit për rritjen e hapësirave, sërisht duhet të punohet në këtë drejtim. Mungojnë totalisht hapësirat jashtë godinave, gjithashtu dhe gjatë vizitës që u zhvillua u konstatua që fluksi i levizjeve ishte shumë i madh dhe vështirësonte lëvizjen e studentëve dhe stafit.

Një problematikë tjetër që lidhet me infrastrukturën është dhe biblioteka. Hapësira e saj ndodhet nën katin 0, dhe kapacitetet ulëse janë të vogla.

IV. Autoritetet akademike të UMSH

Organet drejtuese të UMSH janë, Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Rektorati, Dekanatet, Drejtuesit e Departamenteve, Zv. Rektore, Zv. Dekane, Drejtorë të Qendrave, Administratori i UMSH dhe Administratorët e fakulteteve.



Këto autoritete ushtrojnë funksionet e tyre në përputhje me statutin e institucionit dhe rregulloret e brendshme të tij.

Pranë UMSH janë ngritur dhe Komisionet e Përhershme në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Këto komisione janë, Komisioni i Përhershëm i institucionit për kualifikimin, dhënien e gradave shkencore se dhe promovimin akademik dhe Komisioni i përhershëm për sigurimin e standarteve të cilësisë.

Rektori i UMSH, është Prof. Dr. Adrian Civici, në përputhje me detyrimet ligjore në fuqi.

Secili nga Fakultetet në përbërje të UMSH ka në krye Dekanin sikundër cdo Departament drejtohet nga Drejtuesi i Departamentit.

V. Krijimi dhe riorganizimi i njësive kryesore në UMSH

Me urdhërin e Ministrisë Arsimit dhe Sporteve, Nr. 261, datë 12.05.2022 është miratuar hapja e Fakultetit të Informatikës, bazuar në Vendim Senati Nr. 8/1, datë 15.10.2021 dhe Vendim të Bordit të Administrimit Nr. 8/1, datë 15.10.2021.

Me urdhërin e Ministrisë Arsimit dhe Sporteve Nr. 268, datë 16.05.2022 është riorganizuar Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Humane, bazuar në Vendim Senati Nr. 8/1, datë 15.10.2021 dhe Vendim të Bordit të Administrimit Nr. 8/1, datë 15.10.2021.

Në vendimn e Senatit thuhet se ky riorganizim i fakultetit të ri vjen si ristrukturim i 2 fakulteve, atë të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike. IAL ka përcjellë Vendimin e Senatit Nr. 8/2, datë 30.05.2022 dhe Vendimin e Bordit të Administrimit Nr. 8/2, datë 30.05.2022 për mbylljen e fakultetit të Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike. Me shkresë nr. 383 prot, datë 20.02.2023 UMSH i drejtohet MAS për mbylljen e këtij fakulteti. MAS ka miratuar mbylljen e fakultetit me UMAS Nr. 169, datë 03.04.2023.

V.1 Fakulteti i Informatikës

V.1.1. Departamentet dhe programet e Studimit

Njësia kryesore e krijuar përbëhet nga tre njësi bazë:

- Departamenti i Informatikës së Biznesit
- Departamenti i Teknologjisë së Informacionit
- Qendra e Inovacionit dhe Teknologjive Digjitale

Programet e Studimit

Fakulteti i Informatikës ofron këto programe studimi:

- Programi Bachelor në "Informatikë" me profile: Informatikë Biznesi, Teknologji Informacioni dhe Inxhinieri Informatike. Ky program ka si qëllim kryesor të përgatisë studentë të orientuar drejt zhvillimeve të reja teknologjike dhe profesionistë konkurentë në tregun e punës. Ky profilizim, synon të pasurojë tregun e



profesioneve dhe specialistëve të Informatikës, kryesisht duke ofruar profesione si: zhvillues aplikacionesh, administrator sistemesh, menaxhere projektsh, programues, arkitektë të sistemeve, specialiste TIK etj.;

- Master Profesional në “Sistemet e Informacionit në Biznes”. Ky program studimi ka si qëllim pajisjen e studentëve me njohuritë e nevojshme për ndërtimin dhe zbatimin e sistemeve të informacionit në subjektet e biznesit të tregut shqiptar. Programi sa praktik dhe teorik, synon përgatitjen e një brezi të ri specialistësh programuesish, analistësh dhe menaxhuesish të projekteve që përthithen direkt nga tregu i punës.;
- Master Shkencor në Informatikë me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software”. Programi i studimit Master i Shkencave në Informatikë me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software” ka si qëllim të përgatisë specialistë të Informatikës, me njohuri të profilizuar në fushat e sistemeve të informacionit dhe inxhinierisë software. Duke ndjekur këtë program studimi, studenti merr njohuritë e nevojshme për të bërë një analizë të hollësishme të të dhënave, duke filluar nga mbledhja, përpunimi dhe interpretimi i tyre, në mënyrë që të gjenerojë informacion të vlefshëm, për ta përdorur më tej për qëllimet e biznesit, organizatës apo institucionit në të cilin bashkëpunon.

V.2 Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane


V.2.1. Departamentet dhe programet e Studimit

Njësia kryesore e riorganizuar përbëhet nga katër njësi bazë:


- Departamenti i Edukimit, Komunikimit dhe Formimit të Kompetencave
- Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë
- Departamenti i së Drejtës
- Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare

Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane, ofron këto programe studimi:

- Programi Bachelor në “Drejtësi” (Program i Integruar 3+2). Ky program studimi ka si qëllim pajisjen e studentëve me njohuritë e nevojshme në fushën e drejtësisë. Me këtë program të integruar 5 vjeçar, synohet përgatitja e një brezi të ri juristësh, të aftë për tu përballur me tregun e punës në Shqipëri edhe më gjerë.
- Programi Bachelor në “Marrëdhënie dhe Institucionet Ndërkombëtare”. Ky program studimi ka si qëllim pajisjen e studentëve me njohuritë e nevojshme në fushën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Diplomaci. Studentët e këtij programi studimi, pajisen me njohuritë e nevojshme, për të qenë specialist të këtyre fushave. Pas këtij program studimi, ata e kanë të garantuar vazhdimin e studimeve në nivele më të larta.
- Programi Bachelor në Shkenca Politike dhe Administrative me profile, “Administratë Publike” dhe “Politikat e Integritit dhe Qeverisje”. Ky program studimi ka si qëllim formimin e specialistëve në fushën e shkencave politike dhe administratës publike; të aftë për të punuar në sektorin publik dhe privat. Studentët e këtij fakulteti përgatiten që të kontribuojnë në zhvillimin e kapaciteteve të institucioneve dhe modernizimin e administrimit në sektorin publik dhe privat në Shqipëri. Studentët e këtij program studimi,



- pajisen me njohuritë e nevojshme për vazhdimin e studimeve në nivele më të larta.
- Programi Bachelor në “Studime Psikosociale”. Ky program studimi ka si qëllim formimin e specialistëve në fushën e studimeve psikologjike dhe sociale, të aftë për të punuar në sektorin publik dhe privat si: specialistë të psikologjisë dhe sociologjisë. Studentët e këtij program studimi pajisen me njohuritë e nevojshme për vazhdimin e studimeve në nivele më të larta.
 - Programi Bachelor në “Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun. Ky program studimi ka si qëllim formimin e specialistëve në fushën Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun. Studentët pajisen me instrumentet themelore të domosdoshëm, për të përballuar kërkesat e tregut të punës, për një sërë profesionesh, që lidhen me shumë elementë të funksionimit të bizneseve private, nevojave të veçanta të administratës publike dhe pushtetit vendor. Ky program përmban të gjithë elementet e tjerë të nevojshëm që garantojnë kalimin në mjaft sisteme të mësimin të vazhdueshëm të përshtatshëm për metamorfozat e tregut të punës.
 - Programi Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”
 - Programi Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”
 - Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile “Studime Europiane” dhe “Studime Mesdhetare”. Ky program studimi ka si qëllim formimin e ekspertëve dhe specialistëve në fushën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, duke i profilizuar sipas dy profileve, ndër më të kërkuara në tregun e punës: Studime Europiane dhe Studime Mesdhetare. Programi synon, përgatitjen e një brezi të ri specialistësh të aftë për tu përballur me tregun e punës në Shqipëri edhe më gjerë, duke u bazuar në formimin praktik dhe teorik në marrëdhënie ndërkombëtare dhe diplomaci.
 - Master Profesional në Shkenca Politike dhe Administrative me profile “Administratë Publike”, “Politika Sociale”, “Qeverisje Vendore”. Ky program studimi ka si qëllim përgatitjen e një brezi të ri specialistësh dhe ekspertësh në fushën e studimeve politike, administratës publike dhe politikave sociale, të cilët duhet të jenë të aftë për tu përballur me tregun e punës në Shqipëri edhe më gjerë, duke u bazuar në formimin praktik dhe teorik në shkenca politike dhe administrative.
 - Master Profesional në “Hartim, Menaxhim Projektsh”
 - Master Shkencor në “E Drejtë Civile dhe Tregtare”. Ky program studimi ka si qëllim pajisjen e studentëve me njohuritë e nevojshme në fushën e të Drejtës Civile dhe Tregtare, si dhe në fushat e së Drejtës së Detyrimeve Civile dhe Marrëdhënieve Tregtare. Programi synon përgatitjen e një brezi të ri specialistësh, të aftë për tu përballur me tregun e punës në Shqipëri edhe më gjerë.
 - Master Shkencor në “E Drejtë Publike”. Ky program studimi ka si qëllim pajisjen e studentëve me njohuritë e nevojshme në fushën e të Drejtës Publike, si dhe në fushat e së Drejtës së Institucioneve dhe Marrëdhënieve, ndërmjet shtetasve. Ai synon përgatitjen e një brezi të ri specialistësh, të aftë në fushën e drejtësisë.
 - Master Shkencor në “Marrëdhënie Ndërkombëtare”. Ky program studimi ka si qëllim formimin e ekspertëve dhe specialistëve në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Programi synon përgatitjen e një brezi të ri specialistësh në të aftë për tu përballur me tregun e punës në Shqipëri edhe më gjerë, duke u bazuar në formimin praktik dhe teorik, në marrëdhënie ndërkombëtare dhe diplomaci.



- Master Shkencor në “Studime Politike dhe Strategjitë Ekonomike të Zhvillimit”. Ky program studimi ka si qëllim përgatitjen e një brezi të ri specialistësh dhe ekspertësh në fushën e studimeve politike dhe strategjive të zhvillimit, të cilët duhet të jenë të aftë për tu përballur me tregun e punës në Shqipëri edhe më gjerë. Thellimi i njohurive shkencore në fushën e shkencave politike, do të mundësojë përgatitjen e studentëve si ekspertë dhe specialistë të kësaj fushe.
- Master Shkencor në Psikologji me profile “Psikologji Organizative”, “Psikologji Komunitare” “Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës Sjellor”. Ky program studimi ka si qëllim përgatitjen e një brezi të ri specialistësh dhe ekspertësh në fushën e studimeve psikologjike, të cilët duhet të jenë të aftë për tu përballur me tregun e punës në Shqipëri edhe më gjerë. Thellimi i njohurive shkencore në fushën e shkencave psikologjike, duke u profilizuar në psikologji organizative ose në psikologji komunitare, do të mundësojë përgatitjen e studentëve si ekspertë dhe specialistë të kësaj fushe.

Koment:

Sipas Ligjit Nr. 80/2015 të Arsimit të Lartë, neni 23 pika 2, në përbërje të Fakultetit (njësisë kryesore duhet të jenë 3 njësi bazë, nga të cilat minimalisht 2 duhet të jenë Departamente. Kështu që ky kriter plotësohet.

V.3. Përbërja dhe kualifikimi i personelit akademik sipas departamenteve

Fakulteti i Informatikës

1) Departamenti i Informatikës së Biznesit

Personeli akademik me kohë të plotë paraqitur në raport (PAE), është i përbërë nga **10 pedagogë**, prej të cilëve:

- 1 Prof. Dr.
- 2 Dr.
- 6 Dr (PhD) ne proces
- 1 Msc.

Personeli akademik me kohë të pjesshme paraqitur në raport (PAK), është i përbërë nga **3 pedagogë**, prej të cilëve:

- 1 Prof.
- 1 Dr. ne proces
- 1 Msc.

2) Departamenti i Teknologjisë së Informacionit

Personeli akademik me kohë të plotë paraqitur në raport (PAE), është i përbërë nga **9 pedagogë**:

- 3 Dr./PhD.
- 4 Dr. ne proces
- 2 Msc.




Personeli akademik me kohë të pjesshme paraqitur në raport (PAK), është i përbërë nga **7 pedagogë**:

- 1 Prof. Dr.
- 2 Prof. Asoc.
- 1 Dr.
- 1 Dr. ne proces
- 2 Msc

3) Qendra e Inovacionit dhe Teknologjive Digjitale

Personeli akademik me kohë të plotë paraqitur në raport (PAE), është i përbërë nga **7 pedagogë**:

- 3 Prof. Dr.
- 1 PhD.
- 1 Dr. ne proces
- 2 Msc.

Nuk ka personel akademik me kohë të pjesshme të paraqitur në raport (PAK).

Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane

1) Departamenti i Edukimit, Komunikimit dhe Formimit të Kompetencave

Personeli akademik me kohë të plotë paraqitur në raport (PAE), është i përbërë nga **12 pedagogë**, prej të cilëve:

- 1 Prof. Dr.
- 1 Prof. Asoc.
- 4 Dr.
- 1 Dr (PhD) ne proces
- 5 Msc.

Nuk ka personel akademik me kohë të pjesshme të paraqitur në raport (PAK).

2) Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë

Personeli akademik me kohë të plotë paraqitur në raport (PAE), është i përbërë nga **11 pedagogë**, prej të cilëve:

- 1 Prof. Asoc.
- 8 Dr.
- 1 Dr (PhD) ne proces
- 1 Msc.



Personeli akademik me kohë të pjesshme paraqitur në raport (PAK), është i përbërë nga **4 pedagogë**, prej të cilëve:

- 1 Prof.
- 2 Dr.
- 1 Msc.

3) Departamenti i së Drejtës

Personeli akademik me kohë të plotë paraqitur në raport (PAE), është i përbërë nga **17 pedagogë**, prej të cilëve:

- 2 Prof.
- 2 Prof. Asoc.
- 10 Dr./PhD
- 1 Dr (PhD) ne proces
- 2 Msc.

Personeli akademik me kohë të pjesshme paraqitur në raport (PAK), është i përbërë nga **7 pedagogë**, prej të cilëve:

- 1 Prof. Asoc.
- 2 Dr.
- 4 Msc.

4) Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare

Personeli akademik me kohë të plotë paraqitur në raport (PAE), është i përbërë nga **11 pedagogë**, prej të cilëve:

- 1 Prof. Dr.
- 2 Prof. Asoc.
- 6 Dr.
- 2 Msc.

Personeli akademik me kohë të pjesshme paraqitur në raport (PAK), është i përbërë nga **4 pedagogë**, prej të cilëve:

- 3 Dr.
- 1 Dr. ne proces

Koment:

- Lidhur me numrin e personelit me kohë të plotë të një departamenti (PAE), sipas Ligjit Nr. 80/2015 të Arsimit të Lartë, duhet të jenë minimalisht 7 anëtarë me kohë të plotë. Ky kriter plotësohet për të gjithë departamentet në të dy Fakultetet.
- Përbërja e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit, pavarësisht plotësimit të kriterëve ligjore, në përbërje të këtij departamenti nuk ka staf të kategorisë



- Infrastruktura dhe kapacitetet pritese per studentet dhe stafin. Pavarësisht përpjekjeve të institucionit për rritjen e hapësirave, sërisht duhet të punohet në këtë drejtim. Mungojnë hapësirat rekreative jashtë godinave, gjithashtu dhe gjatë vizitës që u zhvillua në IAL u konstatua që fluksi i levizjeve ishte shumë i madh dhe vështirësonte lëvizjen e studentëve dhe stafit.
- Biblioteka, hapësira e saj dhe kapacitetet ulëse në ambientet e saj. Hapësira e bibliotekës ndodhet nën katin 0, dhe kapacitetet ulëse janë të vogla.
- Stafi i Departamentit të Teknologjisë së Informacionit, pavarësisht plotësimit të kriterëve ligjore, në përbërje të këtij departamenti nuk ka staf të kategorisë Profesor (titulli akademik Profesor i Asociuar dhe Profesor). Grupi *ad hoc* i Vlerësimit të Jashtëm sugjeron rritjen e kapaciteteve të këtij departamenti.

Grupi i *ad hoc* i Vlerësimit të Jashtëm

Prof. Asoc PhD. Kita Sallabanda Diaz



Prof. Dr. Ana Kapaj

